

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18, dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 51, paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-388/1 datë 27.01.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-657/9 datë 18.02.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 7-të mbajtur më 18.02.2025, miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Ndërmarrja Publike Radiodifuzive RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i Tretë Programor (RTMT3), për shkeljen e kryer të nenit 51, paragrafit (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe audiovizuale (LSHMAAV), të mënyrës që në kuadër të shërbimit programor transmetuar më 8 janar 2025, nuk ka ofruar informacion që duhet t'u vinte në dispozicion përdoruesve.

Shkelja nga paragrafi (1) të kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-388/1 datë 27.01.2025, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. DETYROHET që NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i Tretë Programor (RTM3) në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i paraqitur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia, në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të mediave nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Media, LSHMAAV dhe Rregulloret e miratuara në bazë të tij.

Në përputhje me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesit) ndërmerr masë - paralajmërim publik në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në përputhje me nenin 51, paragrafit (1) të LSHMAAV, ofruesit e Shërbimeve Mediatike Audio ose Audiovizuale duhet t'u ofrojnë përdoruesve të tyre qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme së paku për të dhënat në vijim: emrin e ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizual, përkatësisht adresën, shenjën mbrojtëse ose shkurtes të shenjës identifikuese personale (avizo, logon dhe të ngjajshme); adresën e selisë të ofruesit të shërbimit audio ose audiovizual; të dhëna për kontakt me ofruesin e shërbimit mediatik audio ose audiovizual (numër telefoni, e-mail adresë dhe/ose ueb-faqe, personi për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe nëse është e mundur dhe të organit rregullator kompetent.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 27 janar 2025, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative (monitorim) të shërbimit programor televiziv të NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i Tretë

Programor (RTM3), transmetuar më 8 janar 2025, në nivel shtetëror, ku është konstatuar shkelja e nenit 51, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Gjegjësisht, nga mbikëqyrja është konstatuar se më 8 janar 2025, NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i Tretë Programor (RTM3), nuk ka ofruar informacion që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve, përkatësisht nuk ofroj qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme së paku për të dhënat në vijim: emrin e plotë të ofruesit të shërbimit mediatic audioviziv; adresën e selisë të ofruesit të shërbimit mediatic audioviziv; të dhënat për kontakt (numër telefoni, e-mail adresë ose/ueb-faqe; personi përgjegjës për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe për organin rregullator kompetent.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-388/1 datë 27.01.2025, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në përputhje me nenin 23, paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i Tretë Programor (RTM3) me datë 31.01.2025, dërgoi Shkresë ark.nr.10-388/1 datë 31.01.2025, me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-388/1 datë 27.01.2025, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimin të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzoi deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 31.01.2025. Në afatin e parashikuar, NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i Tretë Programor (RTM3), nuk është deklaruar për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 18.02.2025, e shqyrtoi Raportin me shkrim në fjalë dhe konstatoi se NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i Tretë Programor (RTM3) t'i shqiptohet masë - vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 51, paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipa aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-388/1 datë 27.01.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-657/9 datë 18.02.2025, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 18.02.2025, ka miratuar Aktvendim me të cilin publikisht paralajmërohet NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i Tretë Programor (RTM3) dhe detyrohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimin të Aktvendimit, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyruar, i paraqitur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në përputhje me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi, transmetuesi mund të ngrejë padi për iniciimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-388/1 datë 27.01.2025.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi mund të ngrejë padi për fillimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrative paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të aktvendimit.